

VENDIM
Nr. 15/2020

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 84/2019 “PËR
NGRITJEN KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT PËR KONTROLLIN
E LIGJSHMËRISË SË VEPRIMEVE TË KRYERA NGA ANA E PRESIDENTIT
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, NË KUADËR TË USHTRIMIT TË
KOMPETENCAVE TË TIJ LIDHUR ME ZHVILLIMIN E ZGJEDHJEVE
PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, SI DHE PËR TË KONTROLLUAR
LIGJSHMËRINË E VEPRIMEVE DHE PROCEDURËS TË NDJEKUR NGA
PRESIDENTI I REPUBLIKËS NË KUADËR TË EMËRIMIT TË GJYQTARËVE
KUSHTETUES”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 77 dhe 78 të Kushtetutës, të neneve 3, pika 3, 5, pika 2, dhe 8, pikat 1 dhe 3, të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, si dhe të neneve 55, 112, pika 3, dhe 25 të Rregullores së Kuvendit, bazuar në kërkesën e Komisionit Hetimor për zgjatjen e afatit të Komisionit Hetimor,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 84/2019 “ Për të kontrolluar ligjshmërinë e veprimeve të kryera nga ana e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të ushtrimit të kompetencave të tij lidhur me zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, si dhe për të kontrolluar ligjshmërinë e veprimeve dhe procedurës të ndjekur nga Presidenti i Republikës në kuadër të emërimit të gjyqtarëve kushtetues”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

I. Pika VI ndryshohet si më poshtë:

“VI. Afati i veprimtarisë së Komisionit Hetimor zgjatet deri më 31.7.2020.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 16.4.2020